



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY GJILAN**  
Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjilan, Republika e Kosovës  
[e-e.uni-gjilan.net](http://e-e.uni-gjilan.net) tel. +381 (0) 280390112

---

Ref. nr.

---

**Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi**  
**Rektor**

**Fjala e Rektorit në përvjetorin e gjashtë të UKZ**

Të nderuar të pranishëm

Më 6 mars u bënë gjashtë vjet që kurë Universiteti ynë filloi punën.

Sot është dita kur duhet t'i dallojmë disa nga vlerat dhe punën nga 6 marsi i vitit të kaluar.

**1. Cilësia:**

- Monitorimi I cilësisë;
- Zyra për Zhvillim akademik dhe cilësi
- Udhëzuesi për monitorimin e cilësisë dhe përdorimi i vlerësimeve të studentëve në avancimin e stafit akademik
- Rregullore për pranimin dhe avancimin e stafit akademik
- UKZ ka 57 studentë bursistë; në vitin 2018 kemi mundur të ndajmë bursa më dinjitoze për bursistët;
- Në vitin 2018 UKZ ka filluar të subvencionojë pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca ndërkombëtare shkencore dhe financimin e publikimeve në revista shkencore;
- Është formuar Komisioni që do të përgatis rregulloren dhe procedurat për formimin e Këshillit Botues dhe për publikimin e librave universitarë të stafit tonë akademikë.
- Për herë të parë UKZ ka blerë libra.

**2. Projektet ndërkombëtare Erazmus+:**

- “Ngritja e kapaciteteve për ndërkontaktetarizim dhe shkrimin e projektit” (2018) është vlerësuar në grupin e dytë; Koordinator Dukagjin Leka
  - Në 16 projekte Erasmus +, si Partner (2018): UKZ ka fituar dy projekte;
  - “Humbja e shtetësisë të qytetarëve të Luginës së Preshevës”, HERAS, Studentët e Fakultetit Juridik
  - “Kualiteti në ndërkontaktetarizim dhe ngritjen e kapaciteteve për shkrim të projekteve” (2019), koordinator Dukagjin Leka
  - DISOTEK, “Zgjedhja e problemeve me teknologji” (2019), koordinator Xhevdet Thaçi;
  - “Krijimi i klinikave ligjore në fakultetet juridike” (2019), koordinator UKZ dhe Universiteti i Podgoricës;
  - “Integriteti akademik në universitete” (në proces, 2019), bashkë-koordinator: UKZ+Universiteti Kombëtar Teknologjik i Kersonit (Ukrainë)+ Universiteti i Upsalës (Suedi);
  - “Kampanja kundër kopjimit”, HERAS, koordinator: grup I studentëve të Fakultetit Juridik.
  - 9 projekte si partner (2019)
  - Mobiliteti i studentëve po shënon rezultate: pjesëmarrja e një numri të madh të studentëve në Punëtorinë e Gracit (2018), bashkëpunimi me Universitetin e Cugut, me Universitetin e Cyrihut, me Universitetin e Podgoricës dhe me Universitetin e Ohajos.
  - UKZ është anëtarësuar në dy rrjete ndërkombëtare të Universiteteve: Fondacioni i Universiteteve Europiane dhe Rrjeti European për Integritet Akademik.
  - UKZ ka pasur dy profesorë vizitorë në kuadër të Programit Fullbright.
3. Në vitin 2018 ka doktoruar grupi I parë I asistentëve dhe ligjëruesve të UKZ: katër asistentë tanë kanë mbrojtur me sukses tezat e doktoratës.
  4. Progresi i filluar në Administratë

- a. Është krijuar niveli i menaxherëve të mesëm: drejtorët dhe shefat e zyrave
  - b. Po rritet dhe do të rritet stafi administrativ
5. Është krijuar Instituti për Hulumtime në Fakultetin e Edukimit
  6. Është pilotuar projekti “Një a më tepër mësues prej klasës 1-5” në Shkollën “Selami Hallaqi”
  7. Fakulteti I Shkencave Kompjuterike ka filluar digjitalizimin e sallave mësimore. Së shpejti do të digjitalizohet edhe orari mësimor në të gjitha fakultetet.
  8. Fakulteti i Edukimit ka organizuar disa aktivitete në ditët festive, si: ekspozita arti, konkurse garuese për krijimtari letrare, performanca muzikore dhe teatrore etj.
  9. Fakulteti Ekonomik ka organizuar Panairin e Bizneseve.
  10. Zgjedhjet e suksesshme për Këshillin Drejtues të UKZ dhe funksionalizimi i KD
  11. Ceremonia e Diplomimit: deri më sot 637 studentë të diplomuar;

Të nderuar të pranishëm,

nuk do të flas për planet. Nuk do të flas për vështirësitë e vitit 2018 dhe tash.

Një gjë mund të ju garantoj: falë punës së të gjithë juve, studentëve, menaxhmentit, të stafit akademik dhe të administratës, UKZ I ka përballuar dhe do t'i përballoj të gjitha vështirësitë. Vetëm nëpër këto vështirësi ne e forcojmë autonominë tonë dhe cilësinë tonë, dy kushte të domosdoshme për një universitet të suksesshëm.

Universiteti “Kadri Zeka” do t'i bindë të gjithë, edhe ata skeptikët, që është në rrugën më të mirë për t'u bërë një universitet me vlera e cilësi të lartë.

Faleminderit dhe urime të gjithëve viti i gjashtë i UKZ!